



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 86 / 12

Nr. i fq. / Br. st \_\_\_\_\_

Data: / Datum 08.05.2012

VUSHTRRI - VUÇITRN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 41 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.2009/01 për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e kryesuesit të kuvendit të komunës, dhe nenin 42 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më **08.05.2012** mori këtë:

### **V E N D I M**

#### **Për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë**

##### **Neni 1**

Me këtë vendim Habib Mustafa, anëtar i KK-së zgjedhet Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

##### **Neni 2**

Mandati i të lartpërmendurit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit të komunës përfundon me rastin e përfundimit të mandatit të anëtarëve të KK-së.

##### **Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Sekretaria e Kuvendit dhe Menaxheri i Personelit.

##### **Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit në kuvendin e komunës dhe pas nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.



Anëtar i Kuvendit

Qazim Azemi



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 87/12

Nr. i sq. / Br. st \_\_\_\_\_

Data: / Datum 08.05.2012

VUSHTRRI - VUÇITRN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 40.2 "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, si dhe nenin 40.2 "dh" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më **08.05.2012** mori këtë:

### **V E N D I M**

#### **Për ridestinimin e mjeteve buxhetore të komunës**

##### Neni 1

Me këtë vendim bëhet ridestinimi i mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale (programi 644660) të shërbimeve publike, mbrojtjes civile, emergjencës (kodi i projektit 86140), Fondi për bashkëfinancim për shtruarjen e rrugëve me kubëza betoni, vlera e projektit është 299,256.00 €, prandaj nga i njëjti program buxhetor nga projekti në fjalë ridestinohet shuma prej 53,046.21 € për këto projekte:

- Ndërtimi i shëtitorës-trotuarit në bankinën e Lumit "Sitnica", vlera 12,797.65€;
- Asfaltimi i rrugës Pasomë-Rashan ,shuma 40,248.56€.

##### Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.


##### Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Kryesuesi i Kuvendit

*Habib Mustafa*  
Habib Mustafa



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 40.2 "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 si dhe nenin 40.2 "dh" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më **08.05.2012** mori këtë:

### **V E N D I M**

#### **Për transferimin e mjeteve buxhetore të komunës**

##### Neni 1

Me këtë vendim bëhet transferimi i mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale, (programi 644180), të shërbimeve publike, mbrojtjes civile, emergjencës (kodi i projektit 86152) "transport", vlera e projektit është 100,000.00 €, prandaj nga projekti në fjalë transferohet shuma prej 35,200.00 € në këtë program buxhetor:

- Kodi 920, në Drejtorinë Arsimit, nënprogrami i arsimit, administrata (92120) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

##### Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

##### Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa